



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/72

Datë: 06.07.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 2004/48 për Administratën Tatimore dhe Procedurat neni 3.1, Ligjit Nr. 03/L - 071 neni 3 dhe 4, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 06 korrik 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Ministrit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave që Drejtor i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës të emërohet z. Behxhet Haliti.
2. Ngarkohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që vendimin së bashku me CV-në e kandidatit t'ia procedoj për shqyrtim Përfaqësuesit Ndërkombëtar Civil.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/72

Datë: 06.07.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 06 korrik 2009, mori

V E N D I M

1. Plotësohet dhe ndryshohet Udhëzimi Administrativ Nr. 07/2009 për Amendamentimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 18/2005 për Kontrollin Veterinar të Importimit, Kalimit Transit të Produkteve Ushqimore dhe Joushqimore me Origjinë Shtazore të Kafshëve të Gjalla dhe të Materialit për Mbarështimin e Kafshëve.
2. Ngarkohet Zyra për Shërbimet e Ndhmës Juridike në Zyrën e Kryeministrit që në bashkëpunim me Agjencionin Veterinar dhe të Ushqimit të Kosovës të bëjnë plotësimin dhe ndryshimin e këtij Udhëzimi Administrativ.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/72

Datë: 06.07.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 06 korrik 2009, mori

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 300.000 (treqind mijë) Euro për rindërtimin e shtëpive në komunën e Mitrovicës.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga rezervat e paparashikuara të Qeverisë, kategoria ekonomike shpenzimet kapitale dhe transferohen në Kuvendin Komunal të Mitrovicës, kategoria kapitale, programi 480 - "zhvillimi ekonomik".
3. Obligohet Ministra e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/72

Datë: 06.07.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 22 dhe 23 të Ligjit Nr. 02/L - 33 për Investimet e Huaj, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 06 korrik 2009, mori

V E N D I M

Për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit Nr. 06/68, të datës 12.06.2009

1. Ndryshohet dhe plotësohet vendimi Nr. 06/68, i datës 12.06.2009.
2. Në paragrafin 1. d) fjalia "Dy përfaqësues kryesor nga investitorët privat vendor (emërohen nga Qeveria) ", zëvendësohet me " Përfaqësues kryesor nga investitorët privat vendor : Hakif Gashi - Meridian Corporation dhe Bashkim Osmani - Laberion Company.
3. Në paragrafin 1. e) fjalia " Dy përfaqësues kryesor nga investitorët privat të huaj (emërohen nga Qeveria) ", zëvendësohet me " Përfaqësues kryesor nga investitorët privat të huaj : Robert Wright - Raiffeisen Bank dhe Ioannis Gaitanos - Ferronikel
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë